



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 janar 2025

Njoftim për shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: dhjetor, 2024

- Në dhjetor 2024, në pajtim me dinamikën sezonale, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, shënoi rritje mujore prej 5,6%, kryesisht shkaku i rritjes së parave të depozitave dhe depozitave afatshkurtëra, me kontribut pozitiv edhe të parave të gatshme në qarkullim dhe depozitave afatgjata deri në dy vjet. Në bazë vjetore, paraja e gjerë është rritur për 10,2%, si rezultat i rritjes së parave të depozitave, depozitave afatgjata deri në dy vjet, depozitave afatshkurtëra dhe parave të gatshme në qarkullim.
- Totali i depozitave³**, në dhjetor shënoi rritje mujore prej 5,3%, e cila vjen si pasojë e kontributit të depozitave më të larta të të dy sektorëve, me kontribut më të theksuar në sektorin e "amvisërisë". Në nivel vjetor, totali i depozitave u rrit për 12,4%, kryesisht shkaku i rritjes së depozitave të "amvisërive", me rritje edhe të depozitave të sektorit korporativ.

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)						ndryshimet vjetore (so %)						ndryshimet mujore (në %)					
	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024
Paraja e gjerë M4	595,151	591,336	607,881	616,771	631,010	663,289	8.7	9.5	7.6	8.6	10.6	11.4	4.3	-0.7	0.5	-0.7	0.7	5.1
Paraja e gjerë M3	529,264	521,804	535,985	540,047	552,392	583,262	5.9	6.6	5.4	6.7	9.1	10.2	4.5	-0.9	0.4	-1.2	0.6	5.6
<i>nga të cilat:</i>																		
<i>Paratë në qarkullim</i>	50,002	49,336	51,377	52,062	52,448	56,226	5.3	8.6	7.6	9.9	12.8	12.4	7.5	1.5	2.2	-1.9	1.1	7.2
<i>Depozitat e parave</i>	211,402	202,074	211,126	212,711	218,062	236,065	12.4	11.4	8.8	11.3	13.5	11.7	10.0	-1.9	0.3	-0.9	0.7	8.3
<i>Depozitat afatshkurta</i>	215,860	215,551	215,501	212,930	214,596	223,165	0.6	1.0	0.1	-2.0	-1.1	3.4	-0.5	-1.1	0.2	-2.3	-0.4	4.0
<i>Depozitat afatshkurta deri në 2 vjet</i>	51,999	54,842	57,981	62,345	67,286	67,805	4.5	10.8	12.7	23.9	32.1	30.4	2.1	1.4	0.0	3.0	3.7	0.8
Totali i depozitave	534,241	531,140	544,683	555,602	570,298	600,382	8.7	9.3	7.2	8.8	11.0	12.4	4.0	-0.9	0.4	-0.4	0.9	5.3
<i>nga të cilat:</i>																		
<i>Sektorit korporativ</i>	161,432	150,674	153,830	158,056	162,168	176,281	13.2	12.2	4.7	4.7	7.0	9.2	6.6	-2.4	1.0	-0.5	-0.6	8.7
<i>Në denarë</i>	109,266	100,009	103,684	107,476	112,005	119,188	15.8	12.5	5.6	7.9	11.2	9.1	8.5	-3.6	1.7	0.6	-0.5	6.4
<i>Në valutë të huaj</i>	52,166	50,664	50,146	50,580	50,162	57,093	8.2	11.4	2.8	-1.5	-1.3	9.4	2.7	0.1	-0.4	-2.8	-1.0	13.8
<i>Amvisëritë</i>	348,745	354,741	364,432	372,219	381,857	396,898	7.9	8.7	8.9	11.2	13.3	13.8	3.5	0.1	0.0	0.1	1.9	3.9
<i>Në denarë</i>	173,543	177,631	184,627	190,026	197,918	212,504	11.8	13.7	13.1	18.0	21.4	22.4	6.4	0.6	-0.6	-0.3	3.5	7.4
<i>Në valutë të huaj</i>	175,201	177,109	179,805	182,194	183,938	184,394	4.4	4.0	4.8	4.9	5.8	5.2	0.7	-0.3	0.5	0.6	0.1	0.2

Burimi: BPRMV-ja.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për paratë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetar M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

³Totalin e depozitave e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetar M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në dhjetor, **totali i kredive**, shënoi rritje mujore dhe vjetore për 2,7% dhe 11,2%, përkatësisht. Ndryshimi mujor dhe vjetor është rezultat i rritjes së kreditimit në të dy sektoret, me kontribut më të shprehur në sektorin korporativ.

Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar


	gjendja (në milionë denarë)						ndryshimet vjetore (so %)						ndryshimet mujore (në %)					
	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024
Totali i kredive	444,721	449,251	462,435	469,266	481,410	494,449	5.1	6.1	6.4	7.5	9.7	11.2	1.3	0.3	0.8	0.4	0.7	2.7
<i>nga të cilat:</i>																		
Sektori korporativ	212,768	214,268	221,765	223,900	232,121	242,338	3.3	5.4	5.8	7.5	11.5	13.9	2.2	0.0	0.6	-0.1	0.8	4.4
Në denarë	131,089	134,280	144,110	149,795	158,314	166,560	7.1	11.9	16.2	19.7	24.0	27.1	2.7	1.0	2.6	0.9	1.0	5.2
Në valutë të huaj	81,679	79,988	77,656	74,104	73,807	75,777	-2.3	-3.9	-9.3	-10.9	-8.4	-7.2	1.4	-1.7	-2.8	-2.1	0.5	2.7
Amvisëritë	229,404	232,313	238,057	242,919	246,867	249,532	6.7	6.8	7.1	7.7	8.2	8.8	0.5	0.5	1.0	0.8	0.7	1.1
Në denarë	125,223	126,809	130,453	133,210	135,311	136,079	5.1	5.8	7.2	7.6	8.0	8.7	0.0	0.3	1.2	0.8	0.6	0.6
Në valutë të huaj	104,180	105,504	107,603	109,709	111,556	113,454	8.8	8.1	7.0	7.8	8.4	8.9	1.2	0.6	0.7	0.8	0.8	1.7

Burimi: BPRMV-ja.



Burimi: BPRMV-ja.

1. Depozitat dhe kreditë e sektorit korporativ⁴





Burimi: BPRMV-ja.

⁴Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin korporatat publike dhe private jo financiare.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në dhjetor, **depozitat totale të sektorit korporativ** janë rritur për 8,7% në bazë mujore. Njëkohësisht, ndryshimi kryesisht vjen nga rritja e depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe të parave të depozitave, me rritje më të vogël edhe të depozitave afatshkurtëra dhe afatgjata në denarë, ndërsa depozitat afatgjata në valutë të huaj shënuan rënie. Analizuar në bazë vjetore, këto depozita shënojnë rritje prej 9,2%, që vjen si rezultat i rritjes së të gjitha komponentave, me pjesëmarrje më të madhe të parave të depozitave dhe të depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë, me rritje edhe të depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj.
- Kreditë e sektorit korporativ⁵**, këtë muaj, realizuan rritje mujore prej 4,4%, që kryesisht është rezultat i kredive më të larta në denarë, me rritje më të vogël edhe të kredive në valutë të huaj. Rritja vjetore prej 13,9% është tërësisht për shkak të rritjes së kreditimit në denarë.



Burimi: BPRMV-ja.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁶



Burimi: BPRMV-ja.


⁵Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁶Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në dhjetor, **totali i depozitave të amvisërive** u rrit për 3,9% në bazë mujore. Ndryshimi kryesisht është rezultat i rritjes së parave të depozitave, me rritje shtesë edhe të depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj dhe të depozitave afatshkurtëra në denarë, ndërsa depozitat afatshkurtëra në valutë të huaj shënojnë rënie. Në bazë vjetore, rritja është 13,8% dhe është rezultat i rritjes së parave të depozituara dhe të depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, me rënie të depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë.
- Në dhjetor, te **kreditë e amvisërive** është shënuar rritje mujore prej 1,1%, e cila kryesisht vjen nga rritja e kredive në valutë të huaj. Rritja vjetore arrin 8,8% dhe vjen si rezultat i kredive në denarë dhe në valutë të huaj, më i shprehur te kreditë në denarë.



Burimi: BPRMV-ja.



Burimi: BPRMV-ja.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kreditë e bankave dhe kursimoreve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit

	gjendja (në milionë denarë)						ndryshimet vjetore (në %)						ndryshimet mujore (në %)					
	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024	12.2023	3.2024	6.2024	9.2024	11.2024	12.2024
Kreditë konsumatore	119,868	119,858	122,857	125,233	127,183	128,863	6.5	5.8	5.8	6.7	7.3	7.5	1.1	0.4	0.8	0.6	0.7	1.3
Kreditë për banesa	83,891	85,555	87,920	90,191	92,301	94,398	10.5	10.4	10.2	11.0	11.6	12.5	1.4	1.0	0.9	1.0	1.2	2.3
Kreditë për automjete	399	399	419	430	430	418	11.4	13.1	14.6	13.5	10.8	4.7	2.7	1.8	2.1	-0.6	-0.7	-2.9
Kartat e kreditit	9,835	9,459	9,332	9,184	9,107	8,934	-4.7	-6.8	-8.0	-9.0	-9.2	-9.2	-1.9	-0.8	-0.3	-0.8	-1.0	-1.9
Bilancet negative të llogarive rrjedhëse	6,000	6,820	6,846	6,857	6,631	5,738	0.6	6.1	7.9	-1.9	-4.8	-4.4	-13.8	2.3	5.7	4.6	-4.7	-13.5
Kreditë e miratuara mbi baza të tjera	1,782	1,658	1,579	1,563	1,565	1,568	-19.3	-21.2	-18.8	-17.5	-14.3	-12.0	-2.5	-1.7	-2.0	0.7	-0.3	0.2

Burimi: BPRMV-ja.

- Në dhjetor, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, te **kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të përfaqësuar, është shënuar rritje mujore prej 1,3% dhe përkatesisht 2,3%, në kushte të rritjes vjetore prej 7,5% dhe përkatesisht 12,5%. **Kreditë për automjete**, këtë muaj, janë ulur për 2,9% në nivel mujor, me rritje vjetore prej 4,7%. Në nëntor, kreditë e miratuara për **kartelat kreditore**, shënojnë rënie mujore dhe vjetore prej 1,9% dhe 9,2%, respektivisht, ndërsa **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** janë ulur për 13,5% dhe 4,4% në bazë mujore dhe vjetore. Kreditë e miratuara në **baza tjera** janë rritur për 0,2% në bazë mujore, gjatë rënies vjetore prej 12,0%.

Informacione mbështetëse

Të dhënat e serive kohore: Bilance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore: https://www.nbrm.mk/monetarna_statistika-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 shkurt 2025 (mesatarja referuese deri janar 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235). 108/110.